



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-SC-2023-01/CS002

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 13 qershor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Paralajmërim të Fundit

Prokurores së Specializuar:
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt:
Tobi Kadman

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), në bazë të nenit 51(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullës 196(4) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe të nenit 11(2) të Udhëzuesit të Punës për Uljen e Dënimit, lëshon këtë vendim për paralajmërim të fundit për z. Nasim Haradinaj që t’u përmbahet kushteve të lirit të përcaktuara në Vendimin mbi Modifikimin e Dënimit me Shtojca Konfidenciale dhe *Ex Parte* (“Vendimi mbi Modifikimin e Dënimit”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 tetor 2023, Kryetarja lëshoi Vendimin mbi Uljen, Modifikimin ose Ndryshimin e Dënimit, në të cilin, ndër të tjera, konstatoi se modifikimi i dënimit të z. Haradinaj për të mundësuar lirimin e tij me kushte nuk ishte i përshtatshëm në atë kohë, sepse z. Haradinaj në tre raste demonstroi se nuk e respektoi plotësisht kornizën normative të Njesisë së Paraburgimit të Dhomave të Specializuara.²

2. Më 12 dhjetor 2023, Kryetarja lëshoi Vendimin mbi Modifikimin e Dënimit, me të cilin mundësoi lirimin e z. Haradinaj në Kosovë me kushtet e përmendura në atë vendim.³ Në ato kushte përfshihej, ndër të tjera, që ai “të kërkojë leje dhe miratim nga Administratorja për intervista ose çfarëdo kontakti tjetër me median, sikurse përcaktohet në Udhëzuesin e Punës për të Paraburgosurit (Komunikimet me Mediat)”.⁴

3. Më 15 janar 2024, Kryetarja mori një raport nga Administratorja, me të cilin u

¹ F00005, Vendim mbi Modifikimin e Dënimit me Shtojca Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 12 dhjetor 2023 (konfidencial). Vendimi u riklasifikua si publik më 17 dhjetor 2023.

² F00002, Vendim mbi Uljen, Modifikimin ose Ndryshimin e Dënimit, 12 tetor 2023. Versioni i redaktuar publik i vendimit u lëshua më 17 tetor 2023 (F00002/RED).

³ Vendimi mbi Modifikimin e Dënimit, para. 21.

⁴ Vendimi mbi Modifikimin e Dënimit, para. 21(h).

informua se z. Haradinaj kishte pasur kontakt me mediat më 14 dhjetor 2023 dhe përsëri më 8 janar 2024, përmes nxjerrjes së një deklaratë publike, pa kërkuar paraprakisht miratim për të nga Administratorja, siç përcaktohet në Vendimin mbi Modifikimin e Dënimit.⁵

4. Më 22 janar 2024, Kryetarja i kërkoi shefit të Njesisë së Sigurisë të Dhomave të Specializuara që t'i rikujtonte z. Haradinaj kushtet e vendosura për lirim të tij, sidomos në lidhje me kontaktet me mediat dhe deklaratat publike të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Gjithashtu, Kryetarja e udhëzoi shefin e Njesisë së Sigurisë që t'i rikujtonte z. Haradinaj se Vendimi mbi Modifikimin e Dënimit do të revokohej nëse ai shkelte *cilindo* prej kushteve të përcaktuara në të, dhe se do të kthehej në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara për të vuajtur aty pjesën e mbetur të dënimit.

5. Më 7 qershor 2024, Kryetarja mori Raportin e Gjashtë të Përmuajshëm për Kryetaren dhe Njoftimin mbi Zbatimin e Kushteve (Intervista e Dytë me Median) me Tri Shtojca Konfidenciale dhe *Ex Parte*, me të cilin Administratorja e informoi se z. Haradinaj kishte bërë dy intervista me mediat në maj 2024 pa kërkuar paraprakisht leje për to nga Administratorja, sikurse përcaktohet në Vendimin mbi Modifikimin e Dënimit.⁶

6. Më 13 qershor 2024, Kryetarja mori Njoftimin në lidhje me Zbatimin e Kushteve (Intervista të Mëtejshme me Mediat) me Dy Shtojca Konfidenciale dhe *Ex Parte*, ("Njoftimi").⁷ Në të Administratorja njoftonte z. Haradinaj kishte dhënë edhe pesë intervista të tjera për mediat në qershor 2024 dhe se mund të ketë dhënë edhe të tjera,

⁵ F00008, Raporti i Parë i Përmuajshëm i Administratores për Kryetaren dhe Njoftim mbi Zbatimin e Kushteve me Shtojcat 1-2 Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 15 janar 2024 (konfidencial dhe *ex parte*).

⁶ F00018, Raporti i Gjashtë i Përmuajshëm i Administratores për Kryetaren dhe Njoftimin mbi Zbatimin e Kushteve (Intervista e Dytë me Median) me Tri Shtojca Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 7 qershor 2024 (konfidencial dhe *ex parte*).

⁷ F00019, Njoftim në lidhje me Zbatimin e Kushteve (Intervista të Mëtejshme me Mediat) me Dy Shtojca Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 13 qershor 2024 (konfidencial dhe *ex parte*).

pa kërkuar paraprakisht leje për to nga Administratorja, sikurse përcaktohet në Vendimin mbi Modifikimin e Dënimit.⁸

II. SHQYRTIM

7. Kryetarja rikujton se lirimi me kusht i z. Haradinaj u shty me dy muaj për shkak të tre rasteve të shkeljes të rregullave në objektin e paraburgimit prej tij. Kryetarja vëren se edhe pas lirit të tij me kushte, z. Haradinaj duket se vazhdon me të njëjtën mënyrë sjelljeje. Kryetarja vë në dukje se në janar 2024, shefi i Njësisë së Sigurisë i rikujtoi z. Haradinaj se duhet t'u përmbahej kushteve të përcaktuara në Vendimin mbi Modifikimin e Dënimit, si edhe se cilat do të ishin pasojat nëse z. Haradinaj do të shkelte *cilindo* prej atyre kushteve.

8. Kryetarja vëren se gjatë dy muajve të fundit z. Haradinaj ka kontaktuar edhe më rregullisht me mediat pa kërkuar paraprakisht leje për këtë, sikurse përcaktohet në Vendimin mbi Modifikimin e Dënimit. Kryetarja thekson se Vendimi mbi Modifikimin e Dënimit mund të revokohet ose modifikohet menjëherë mbi bazën e shkeljeve të fundit të atij vendimi nga z. Haradinaj.⁹ Megjithatë, Kryetarja është e mendimit se zotit Haradinaj duhet t'i jepet edhe një paralajmërim *i fundit*, drejtpërdrejt prej saj, përpara se të revokohet Vendimi mbi Modifikimin e Dënimit dhe të urdhërohet kthimi i tij në objektin e paraburgimit për të vuajtur aty pjesën e mbetur të dënimit.

9. Kryetarja thekson se çdo shkelje tjetër nga z. Haradinaj e kushteve të përcaktuara në Vendimin mbi Modifikimin e Dënimit, sado e vogël, do të rezultojë në kthimin e tij të menjëhershëm në objektin e paraburgimit.

⁸ Njoftimi, para. 3-4.

⁹ Vendimi mbi Modifikimin e Dënimit, para. 22.

III. VENDIM

10. Bazuar në sa më sipër, Kryetarja

- i). **PARALAJMËRON** z. Haradinaj që t'u përmbahet të gjitha kushteve të përcaktuara në Vendimin mbi Modifikimin e Dënimit; dhe
- ii). **I RIKUJTON** zotit Haradinaj se, nëse shkel ndonjë prej kushteve, Vendimi mbi Modifikimin e Dënimit do të revokohet me efekt të menjëhershëm dhe ai do të kthehet në objektin e paraburgimit për të vuajtur aty pjesën e mbetur të dënimit.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E enjte, 13 qershor 2024
Në Hagë,
Holandë